


NHS PHARMACY FIRST SCOTLAND


KËSHILLA | TRAJTIM | REFERIM



**KËSHILLA PËR
SIMPTOMAT TUAJA**



**TRAJTIM NËSE
REKOMANDOHET**



**REFERIM NË
SHËRBIME TË TJERA**

Informacion për pacientët



**Healthier
Scotland**
Scottish
Government



Çfarë është NHS Pharmacy First Scotland?

- **NHS Pharmacy First Scotland** është një shërbim i NHS i ofruar nga farmacia e komunitetit tuaj lokal (një farmaci me kontratë për të ofruar receta dhe shërbime të NHS).
- Nëse keni një sëmundje të lehtë, farmacia është vendi i parë ku duhet të shkoni për këshilla.
- Zakonisht nuk keni nevojë për të lënë takim dhe mund të shkoni në çdo farmaci.
- Farmacisti juaj mund t'ju japë këshilla për një sëmundje të lehtë dhe ilaçe nëse mendojnë se keni nevojë për të.

Për kë është shërbimi?

Ju mund ta përdorni **NHS Pharmacy First Scotland** nëse jeni regjistruar te një mjek i përgjithshëm në Skoci ose jetoni në Skoci. Flisni me ekipin e farmacistëve nëse keni nevojë për detaje të mëtejshme.

Si funksionon shërbimi?

- Farmacistët dhe ekipet e tyre janë ekspertë në mjekësi dhe mund të ndihmojnë me shqetësime të vogla shëndetësore.
- Një farmacist mund t'ju japë këshilla dhe trajtim (nëse keni nevojë) për sëmundje të lehta si në vijim.

Akne	Morra koke
Alergji	Hemorroide
Këmba e atletit	Alergji ndaj barit
Dhimbje shpine	Impetigo
Hundë e bllokuar ose që kullon	Dispepsi
Herpes buzësh	Ulçera në gojë
Kapsllëk	Dhimbje periodike
Kollë	Dhimbje fyti
Cistit (te femrat) Diarre	Krimba
Dhimbje veshi	Ekzemë
Ekzemë	Lytha
Dhimbje koke	Kallo

- Farmacistët, si mjekët e përgjithshëm, mund të ofrojnë vetëm disa ilaçe dhe produkte në NHS. Të gjitha këto janë provuar të jenë efektive për trajtimin e gjendjes tuaj. Nëse dëshironi një ilaç ose produkt specifik, mund t'ju duhet ta blini atë. Farmacisti do t'ju japë këshilla për këtë.
- Nëse farmacisti mendon se është më mirë për ju të vizitoni mjekun tuaj të përgjithshëm, ai mund t'ju referojë drejtpërdrejt ose t'ju thotë të lini një takim.

Si ta përdor shërbimin?

- **NHS Pharmacy First Scotland** ofrohet nga të gjitha farmacitë në Skoci që japin receta të NHS.
- Ju mund të zgjidhni cilën farmaci të përdorni.
- Në shumicën e rasteve, nuk keni nevojë të lini një takim.
- Kur vizitoni farmacinë, farmacisti (ose një nga ekipi i tyre) do t'ju kërkojë disa informacione, duke përfshirë emrin, datën e lindjes dhe kodin postar.
- Farmacisti:
 - o do t'ju pyesë për simptomat tuaja;
 - o do t'ju japë këshilla për gjendjen tuaj;
 - o do t'ju sigurojë ilaçe (nëse keni nevojë); dhe
 - o do t'ju referojë te një profesionist tjetër i kujdesit shëndetësor (për shembull, mjeku juaj i përgjithshëm) nëse ai mendon se kjo është e nevojshme.
- Ai do të krijojë një Regjistrim të Mjekimit të Pacientit (PMR) për të mbajtur shënim çdo këshillë dhe trajtim që ju jep.
- Ju mund të kërkonte të përdorni zonën ose dhomën e konsultimit të farmacisë nëse dëshironi të flisni privatisht me farmacistin.

A mund të shkoj edhe në farmaci të tjera?

- Po, mund të shkoni në çdo farmaci për të blerë ilaçe, për të marrë receta ose për të përdorur shërbimin **NHS Pharmacy First Scotland**. Ju nuk keni nevojë të përdorni gjithmonë të njëjtën farmaci.
- Megjithatë, nëse përdorni gjithmonë të njëjtën farmaci, farmacisti mund të krijojë një regjistër të trajtimit tuaj, i cili mund t'ju ndihmojë të menaxhoni gjendjen tuaj në mënyrë më efektive. (Ky regjistër nuk ndahet me askënd tjetër.)

Po sikur të jem i pakënaqur me shërbimin që kam marrë nga farmacia?

- Fillimisht, bisedoni me farmacistin që ai të përpiqet ta zgjidhë menjëherë çështjen.
- Nëse nuk mund ta bëni këtë, ose nëse keni folur tashmë me farmacistin tuaj dhe jeni ende i pakënaqur, mund të kontaktoni me ekipin e komenteve dhe ankesave në bordin lokal të shëndetit të NHS-së. Të dhënat e kontaktit jepen në faqen e internetit të NHS Inform www.nhsinform.scot.

Si të mësoni më shumë

- Për më shumë informacion rreth diçkaje në këtë broshurë, kontaktoni me:
- farmacinë tuaj lokale;
- mjekun juaj ose me një anëtar të stafit të NHS-së të përfshirë në kujdesin tuaj;
- linjën e ndihmës të NHS Inform në numrin **0800 22 44 88** (thirrjet nga një telefon fiks janë falas), ose në faqen e internetit të NHS Inform në www.nhsinform.scot;
- Shërbimin e Këshillimit dhe Mbështetjes së Pacientëve (PASS) në 0800 917 2127 ose zyrën lokale të këshillimit të qytetarëve (gjenerali zyrën tuaj më të afërt në faqen e internetit www.cas.org.uk ose në numërorin lokal telefonik).

Ky informacion është i disponueshëm në faqen e internetit të Qeverisë Skoceze (www.gov.scot) dhe në faqen e internetit të NHS Inform (www.nhsinform.scot).



Scottish Government
Riaghaltas na h-Alba
gov.scot

© Të drejtat e autorit nga Kurora Mbretërore 2020

OGL

Ky publikim është i licencuar sipas kushteve të Open Government Licence v3.0, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe. Për të parë këtë licencë, vizitoni nationalarchives.gov.uk/doc/open-government-licence/version/3 ose shkruani në adresën Information Policy Team, The National Archives, Kew, London TW9 4DU ose dërgoni email në: psi@nationalarchives.gsi.gov.uk.

Aty ku ne kemi identifikuar ndonjë informacion mbi të drejtën e autorit nga palët e treta, do t'ju duhet të merrni leje nga mbajtësit të së drejtës së autorit në fjalë.

Ky publikim është i disponueshëm në www.gov.scot

Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:
The Scottish Government
St Andrew's House
Edinburgh
EH1 3DG

ISBN: 978-1-83960-444-7

Rishikuar dhe ribotuar me një ndryshim të vogël në faqen 7.

Publikuar nga Qeveria Skoceze, prill 2020

Prodhuar për Qeverinë Skoceze nga APS Group Scotland, 21 Tennant Street, Edinburgh EH6 5NA
PPDAS675394 (04/20)

W W W . g o v . s c o t